



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e martë, në datën 09 nëntor 2021, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës, shoqërisë “Inter Active Media” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në Allotmentin Tiranë”. **(Vendimi nr. 90, datë 09.11.2021)**
2. Miratimin e ndryshimeve në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Media Kontakt” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Radio Kontakt”. **(Vendimi nr. 91, datë 09.11.2021)**
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Digit-Alb” sh.a., licencuar/autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive duke vendosur ndryshimin e emrit të shërbimeve programore audiovizive nga “*Digitalb 1HD*” në “*Gold HD*” dhe nga “*Digitalb 2HD*” në “*Max HD*” **(Vendimi nr. 92, datë 09.11.2021)**
4. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “I.B.C-Telecom” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio I.B.C”. **(Vendimi nr. 93, datë 09.11.2021)**
5. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Nisatel” sh.p.k., dhe lënien në fuqi të Vendimit, për dënim me gjobë nr. 11 datë 29.09.2021, në masën 1 000 000 lekë, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit, ndaj subjektit OSHMA të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP (OTT) “Nisatel”. **(Vendimi nr. 94, datë 09.11.2021)**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 09.11.2021**